

RELACION

Mbi zhvillimin e takimit konsultues në kuadër të hartimit të Planit të Veprimit OGP 2026–2030

Në kuadër të procesit të bashkë-krijimit për hartimin e Planit të ri të Veprimit të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP) 2026–2030, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) organizoi një takim konsultues në qytetin e Peshkopisë.

Takimi u zhvillua me pjesëmarrjen e rreth 15 individëve, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, aktorëve lokalë, si dhe qytetarëve të interesuar. Qëllimi i këtij takimi ishte mbledhja e mendimeve, sugjerimeve dhe prioriteteve nga niveli vendor, për të kontribuar në hartimin e një plani veprimi gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt nevojave reale të komunitetit.

Gjatë takimit, pjesëmarrësit u njohën me parimet dhe objektivat e OGP-së, si dhe me rëndësinë e përfshirjes aktive të qytetarëve dhe shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse. Diskutimet u fokusuan në identifikimin e sfidave kryesore në nivel lokal, transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike, si dhe forcimin e mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe komunitetit.

Pjesëmarrësit ngritën një sërë çështjesh me interes, ndër të cilat:

- Nevoja për rritjen e transparencës në nivel vendor;
- Përmirësimi i aksesit në informacion publik;
- Rritja e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje;
- Mbështetja dhe fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile në zonat jashtë qendrave urbane.

Në përfundim të takimit, u theksua rëndësia e vijimit të këtij procesi konsultimi në mënyrë të hapur dhe gjithëpërfshirëse, duke siguruar që kontributet e marra nga aktorët lokalë të reflektohen në mënyrë konkrete në Planin e Veprimit OGP 2026–2030.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile mbetet e angazhuar për të vijuar bashkëpunimin me të gjithë aktorët relevantë, me synim ndërtimin e një qeverisjeje më transparente, të përgjegjshme dhe të hapur ndaj qytetarëve.

Konkluzione dhe Masa të Rekomanduara për Strategjinë OGP 2026–2030

- Rritja e transparencës në nivel vendor përmes publikimit proaktiv të informacionit dhe përmirësimit të platformave online;
- Përmirësimi i aksesit në informacion publik duke thjeshtuar procedurat dhe rritur ndërgjegjësimin qytetar;
- Forcimi i pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje përmes konsultimeve periodike dhe mekanizmave gjithëpërfshirës;
- Mbështetja e organizatave të shoqërisë civile në zonat jashtë qendrave urbane përmes financimit dhe ngritjes së kapaciteteve;
- Digjitalizimi i shërbimeve publike dhe rritja e aksesit për grupet vulnerabël;
- Rritja e kapaciteteve institucionale dhe forcimi i koordinimit ndërinstitutional për zbatimin e OGP;